

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2005

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur rolin e rëndësishëm që ligji “Statusi i nëpunësit civil” i jep Komisionit të Shërbimit Civil në mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil;
- duke pranuar rolin e këtij institucioni të pavarur si organi administrativ i ngarkuar për zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve në lidhje me nëpunësin civil;
- duke theksuar rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve ndërinstytucionale ndërmjet Komisionit të Shërbimit Civil dhe institucioneve të tjera ligjvënëse, ekzekutive, gjyqësore dhe atyre të pavarura;
- duke insistuar në domosdoshmërinë e thellimit të reformave në administratën publike, në kuadër të procesit të integritetit në BE;

Vëren:

- tejkalimin e kompetencave të Komisionit të Shërbimit Civil për sa i përket detyrave të veta ligjore për sigurimin e një administrate profesionale dhe të paanshme;
- shfaqje të mungesës absolute të objektivitetit dhe mungesë të transparencës në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civilë ndaj administratës publike, në lidhje me të drejtat që parashikon statusi i nëpunësit civil;
- qëndrime të pajustificuara, joprofesionale, politike dhe klienteliste gjatë procesit të vendimmarrjes;

Tërheq vëmendjen:

- për punën e pamjaftueshme në përmbushjen e detyrave të tij ligjore dhe rekomandimeve të dhëna për sigurimin e një administrate profesionale dhe të paanshme në të gjitha nivelet e saj;
- për mungesën e paanshmërisë politike lidhur me gjykimet në raport me reformën administrative, si një ndër standardet që kërkon BE-ja;
- për reagim të pamjaftueshëm ndaj mosekzekutimit të vendimeve të këtij institucioni nga administrata publike;
- për heshtjen e pajustificuar ndaj nivelit të lartë të korrupsionit në administratën publike, fenomen ky i vënë në dukje veçanërisht nga raportet e institucioneve ndërkombëtare.

Kërkon për vitin 2006:

- rritjen e nivelit cilësor dhe të kapaciteteve profesionale të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të Sekretariatit Teknik të këtij institucioni në ushtrimin e detyrave të tyre ligjore;
- krijimin e një performance të qartë në zbatimin e objektivave strategjike për ekzekutimin e prioritetëve të partneritetit europian, me qëllim thellimin e reformave në administratën publike në funksion të integritetit në Europë;
- ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit frytdhënës me institucionet dhe organizmat e tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
- rritjen e këmbënguljes së institucionit dhe dhënien e kontributit në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- hartimin e rekomandimeve dhe ndjekjen e tyre për përmbushjen e sugjerimeve të dhëna në nivel qendror e vendor;
- përmirësimin e rolit të Komisionit të Shërbimit Civil për mbikëqyrjen e implementimit të legjislacionit të shërbimit civil dhe në nivelin e administratës së pushtetit vendor;
- bashkëpunim me Këshillin e Ministrave për kryerjen e reformës në administratë, në përputhje me statusin e nëpunësit civil.

Tiranë, më 16.2.2006